



PËRGJËGJSIA 2020

SOCIALE



Veprimtaritë kryesore gjatë vitit 2020

Albsig-Jetë Sesion Trajnimesh me bizneset në Durrës e Tiranë

Shoqëria e Sigurimeve Albsig Jetë, ka ndërmarrë një nismë të rëndësishme për informimin e bizneseve për produktet dhe tarifat e tyre . Duke mbyllur vitin e parë të aktivitetit Albsig ka hedhur në treg oferta të përshtatshme për sigurimet e jetës. Edhe pse vit pandemik dhe i kufizuar Albsig e ka përmbyllur atë me arritje të shkëlqyer në treg përse i përket sigurimit të jetës.

Albsig Jetë me një staf të kualifikuar dhe profesionist e ka filluar sesionin e trajnimeve për rëndësinë e produkteve të jetës me bizneset e përqendruara më shumë në qytetet Tiranë e Durrës duke u zgjatur më pas dhe në qytetet e tjera sipas rrjetit të shitjeve të Albsig.

Qëllimi i trajnimeve të Albsig Jetë është njohja e produkteve tarifave dhe mundësinë e qasjes së klientëve duke plotësuar portofolin e produkteve që ata tashmë disponojnë jo vetëm nga Albsig Sh.a. . Përmes trajnimeve, programeve dhe nismave të ndërmarra Albsig Jetë synon në përfshirjen e komunitetit në aktivitetet e organizuara, në sfera të ndryshme të jetës sociale.

Albsig Jetë sh. a takim me universitetin “Epoka” për zhvillimin e edukimit financiar të brezit të ri

Albsig Jetë Sh.a "Edukimi financiar i brezit të ri dhe njohja me rëndësinë e sigurimit të Jetës ".

Ky ka qenë qëllimi i takimit me studentët e Universitetit Epoka, takim ky i realizuar nga stafi i drejtuesve të Albsig Jetë. Fokusi i këtij takimi ishte mbështetje, sensibilizimi dhe njohja e brezit të ri me rëndësinë e sigurimit të jetës, për një të ardhme më të sigurtë.

Aktiviteti sensibilizues i Albsig Jetë me studentët e Universitetit Epoka vjen në kuadër të marrëveshjes që “Epoka” ka me “Albsig”. Përveç mundësisë për trajnim, të rinjtë e “Epokës” mund të jenë pjesë e trajnimeve profesionale ekstrakurrikulare dhe komplementare, bazuar në aspektin praktik.

Ky bashkëpunim do të vijojë më tej dhe me këshillime apo trajnime individuale për studentët e “Epokës”, duke nisur që nga hartimi i një CV–je të suksesshme e deri te përballja me punëdhënësin. Albsig Jetë sh.a ofron për të rinjtë e këtij universiteti lehtësinë dhe komoditetin në zhvillimin e praktikave dhe intershipeve duke u këshilluar me ekspertë. Kështu, që në këtë stad, studentët e “Epokës” janë të informuar dhe mund të punojnë për të plotësuar kriteret profesionale që kërkohen për të qenë pjesë e stafit të Albsig Jetë sh.a.

Albsig është partner i universiteteve publike dhe private në vend duke marrë pjesë aktivisht në panairët e punës dhe seminare të ndryshme si dhe përmes ofrimit të praktikave mësimore në zyrat qëndrore. Panairët e punës të zhvilluara nga universitete të ndryshme kanë qenë në fakt prezantimi i parë me disa të rinjtë të cilët tashmë janë pjesë e stafit të Albsig Jetë, Albsig Invest dhe Albsig sh.a.

Albsig Jetë.sh.a shpërndan maska dhe dezinfektantë për konsumatorët

Stafi i Albsig Jetë sh.a ka ndërmarrë iniciativën kryesore për të shpërndarë masat mbrojtëse kundër Covid 19.

Në mjediset e brëndshme të Kalasë së Tiranës në eventin e organizuar nga Albsig sh.a, Albsig Jetë.sh.a dhe Albsig Invest sh.a, pjesë të Kastrati Group, janë shpërndarë dezinfektantë dhe maska për të gjithë pjesëmarrësit në eveniment.

Rreth 2,000 maska dhe 500 dezinfektantë janë shpërndarë për të pranishmit njëkohësisht janë bërë publike dhe të gjitha masat që ka ndërmarrë shoqëria për suportin dhe mbrojtjen nga Covid 19 jo vetëm për punonjësit dhe klientët e saj por për të gjithë komunitetin në nevojë. Pjesëmarrëse në aktivitet ishin dhe një grup kryefamiljaresh të cilat ishin me probleme social-ekonomike. Gratë në përgjithësi, por ato krye-familjare veçanarisht, janë grupi më i diasavantazhuar dhe i prekur nga situata e shkaktuar nga COVID-19, prandaj ndihma dhe mbështetja e tyre duhet të jetë prioritet i të gjithë aktorëve dhe vendim-marrësve lokal dhe qendror. Kriza sociale e shoqëruar me krizë ekonomike është shkatërrimtare për to dhe familjet e tyre.

Faleminderit Albsig për mbështetjen e grave, nënave dhe motrave tona të gjendura sot në këtë vështirësi!

Albsig Jetë, seminar me studentët e Fakultetit të Tiranës.

“Rëndësia e sigurimit të jetës dhe impakti social dhe financiar që ka”, kjo është tema e seminarit të zhvilluar nga stafi i Albsig Jetë në auditorët e Fakultetit të Tiranës. Studentët e fakultetit të Tiranës dega Ekonomik kanë zhvilluar një seminar në lidhje me rëndësinë e sigurimit të jetës dhe impaktin social financiar mbi konsumatorët. Edhe pse një kulturë e munguar kjo për sigurimin e jetës, studentët janë target grupi kryesor që mund të ndryshojë kulturën mbi sigurimet. “Është shumë e rëndësishme të kuptojmë sigurimin e jetës dhe impaktin social dhe financiar që keto sigurime kanë te konsumatorët. Një rëndësi të veçantë kanë dhe brezi i ri që përmes këtyre të fundit të mund të thyhet “tabuja” mbi sigurimet”, sqaron drejtori i Albsig Jetë. Përmes seminareve me tema kaq të rëndësishme jo vetëm për rëndësinë e sigurimit të jetës, por edhe për impaktin social ekonomik që sigurimet në përgjithësi kanë për vendin, Albsig Jetë po çon më tej objektivat e punës së saj për vendosjen e marrëdhënieve sa më ndërvepruese të edukimit me pedagogët dhe studentët e universitetit Ekonomik, pasi janë pikërisht ata që më shumë se kushdo mund ta sjellin sa më pranë aktivitetin dhe mendësinë e Albsig Jetë sidomos tek të rinjtë, tek nxënësit e tyre, por edhe tek të afërmit, miqtë dhe kolegët e tyre.

Në këtë nismë të saj, Albsig Jetë po ecën nën shembullin e më të mirëve, aktiviteti i të cilëve, përditë e më shumë po i përkushtohet edhe çështjeve të edukimit dhe transparencës ndaj publikut të gjerë. Në morinë e detyrave dhe punës së saj, Albsig Jetë ka vënë kështu në qendër të vëmendjes edhe objektivin e edukimit të publikut, duke synuar të vendosë ura komunikimi me të gjitha grupet e interesit në vend, për të siguruar një mjedis të përshtatshëm të zhvillimit të veprimtarisë së saj.

“ Në emër të jetës”, nismë e Albsig Jetë në ndihmë për moshat e treta

“Në emër të jetës” kjo është nisma e ndërmarrë nga stafi i Albsig Jetë për të ndihmuar të moshuarit për të përballuar sa më lehtë situatën e krijuar nga pandemia e Covid 19. Nisma është përfaqëuar nga të gjitha degët e Albsig Jetë nëpër rrethe dhe ka startuar në Tiranë për t’u pasuar më pas nga çdo degë e rrjetit të shitjeve të Albsig. Në situatën e pandemisë të moshuarit ishin dhe një nga grupet më të prekura nga prob-lematikat e situatës. Kjo për faktin se një pjesë e tyre jetojnë vetëm dhe një pjesë tjetër kanë as kushtet më minimale të jetesës. Këto problematika janë hasur edhe më shumë nëpër rrethe ku një numër i konsiderueshëm të moshuarish bënin thirrje publike për ndihmë. Një ndër to ka qenë dhe nënë Myzejene Jaupaj, 84 vjeçe nga Vlora e cila apeloj për ndihmë ushqimore. Ishte dega e Albsig Gjirokastër e cila i erdhi në ndihmë të moshuarës. “Ndhimja ushqimore për një periudhë tre mujore dhe disa ndihma në veshmbathje ishin dhe kontigjenti i parë me të cilën u pajis e moshuara nga ana jonë”, tregon Drejtori i Degës Albsig Gjirokastër. Kësaj ndihme i janë bashkëngjitur edhe degët e tjera të cilat kanë mundur të ndihmojnë sadopak moshat e treta në nevojë.



Dhurata më e bukur

JETA

Ju mund të dhuroni njerëzve të dashur këtë fundvit një nga kontratat e Sigurimit të Jetës:

SIGURIMI I JETËS PËR HUA

SIGURIMI I JETËS DHE AKSIDENTEVE

Albsig Jetë takim me Bashkitë e ndryshme për rëndësinë e sigurimit të jetës

Shoqëria e Sigurimeve Albsig Jetë zhvilloi një takim konsultues dhe informues për rëndësinë e sigurimit të jetës dhe impaktin social ekonomik që sjell ajo në shoqëri, me përfaqësues nga Bashki të qyteteve të përfshirë dhe Bashkinë e Tiranës.

Qëllimi i këtij takimi ishte dëgjimi i shqetësimeve dhe opinioneve të përfaqësuesve të bashkive si dhe shkëmbimi i mendimeve në lidhje me rëndësinë e sigurimit të Jetës. Gjatë takimit u ndanë informacione dhe udhëzime praktike për rëndësinë e sigurimit të jetës jo vetëm me banka por dhe vullnetare, procedur-at e rimbursimit, etj.

Përfaqësuesit e bashkive vlerësuan pozitivisht iniciativën që Albsig Jetë ka ndërmarrë në lidhje me këto takime dhe u shprehën në favor të bashkëpunimit. Ata parashtruan kërkesat e tyre për rritjen e shkallës së informimit të qytetarëve nga ana Albsig Jetë si dhe lehtësimin e procedurave në rast sigurimi.



PËRGJËGJSIA SOCIALE

2020

ADRESA

Rr. "Barrikadave",
Albsig HQ, Kati 8,
Tiranë - Shqipëri

KONTAKT

+355 (0) 254770
info@albsig-jete.al
www.albsig-jete.al